



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE PËRPUTHSHMËRISË PËR ARSIMIN,
SPORTIN DHE RININË
DREJTORIA E PROGRAMIMIT, STANDARDIZIMIT DHE HARMONIZIMIT
TË KUADRIT RREGULLATOR

Nr. 997 Prot.

Tiranë, më 29.01. 2019

Lënda: Mbi zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave

UNIVERSITETIT TË TIRANËS
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS
UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË
UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS
UNIVERSITETIT TË ARTEVE, TIRANË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR XHUVANI", ELBASAN
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË
UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR
UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS
AKADEMISË SË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, TIRANË
AKADEMISË SË FORCAVE TË ARMATOSURA
AKADEMISË SË SIGURISË

Të nderuar,

Me vendimet nr. 39, datë 23.01.2019 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në vendimin nr.903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondit i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar dhe nr. 40, datë 23.01.2019 të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 269, datë 29.3.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e

shkollimit”, të ndryshuar, janë unifikuar kategoritë që përfitojnë përjashtim nga tarifat dhe bursa financiare.

Për sa më sipër:

1. Studentët që ndjekin studimet në IAL-të publike, në programe studimi profesionale, programe të ciklit të parë të studimeve apo programe të integruara të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2018-2019, që kanë aplikuar tashmë për bursa dhe përjashtim nga tarifat dhe i plotësojnë kriteret, të trajtohen menjëherë nga Bordi i Administrimit.
2. Studentët që ndjekin studimet në IAL-të publike, në programe studimi profesionale, programe të ciklit të parë të studimeve apo programe të integruara të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2018-2019 dhe që u ka lindur e drejta për bursa dhe përjashtim nga tarifat me hyrjen në fuqi të këtyre unifikimeve, të trajtohen brenda afateve të përcaktuara në këto vendime nga Bordi i Administrimit.

Bashkëlidhur gjeni vendimet e sipërcituara për dijeni dhe zbatim.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

MINISTËR

BESA SHAHINI
